

Janë monopol i Mirditës; nuk ësht' e vërtetë se këto i kam parë edhe në Malësit' e tjera.

Të hymë në një tjetër fushë tani, mos pandeni se Mirditasi nuk ka vesh të mirë. Kur i bie sheftelisë të mer mëntë si thotë një ljal'e vjetër, me gjithqë përdor edhe një instrument primitif. Kësaj vegle i bien rëndom edhe është një tjetër mjet zbavijeje. Edhe e shëkon burrin e dheut të riqë këmbë-kryq dhe të luajë gjishtërinjtë me një shejtësi të madhe mi bishtin e tamburasë. Reth e rotull këtij miku, më këmbë ose këmbë-kryq, munt të sillni ndër mënt burrat e tjerë të dëgjojnë me një interes të math këngëtorin me nam, i cili s'lodhet t'ja marë edhe një a dy herë për hirin e dëgjonjësvet. Këngët munt të kenë nonjë melodi të bukur, mirëpo janë sadë të gjata edhe kështu e mërzitin veshin me përsëritjen e kësaj melodie të thjeshte. Duket se Mirditasit i pëlqejnë më tepër fjalet se sa avazi i këngës. Që t'i tregojnë këngëtorit se mbetnë të kënaqur prej këngës që ja mori, të gjithë me një gojë i thonë "Të lumt gojal! Të këndoft zemra!" kur e mbaron.

Për veç sheftelisë i bien edhe fyellit, kavalilit, bilbilit edhe zambares. Thonë se fyellit i ka pas ra Dreqi, kurse kavallit Krishti. Kavalilit e kanë bërë prej hekurit të një pushke të gjatë. Bilbili edhe zambarja janë goditur prej